



Tiranë, më 09.11.2019

REZOLUTË

“PËR BARAZINË GJINORE DHE RATIFIKIMIN E KONVENTËS NR.190 “PËR DHUNËN DHE NGACMIMIN”, SI DHE REKOMANDIMIN NR 206 -PËR DHUNËN DHE NGACMIMIN”

Konfederata e Sindikatave të Shqipërisë e vlerëson barazinë gjinore si një kusht përcaktues për një shoqëri të drejtë, të qëndrueshme, solidare, të emancipuar dhe ekonomikisht të zhvilluar, prandaj punën e saj për barazinë gjinore e konsideron si një objektiv dhe prioritet angazhimi për të vepruar, bashkëpunuar dhe koordinuar punën me të gjithë aktorët, të cilët besojnë se promovimi i barazisë gjinore do të thotë kontribut për një shoqëri demokratike, të hapur dhe të emancipuar, në thelb, kontribut për një shoqëri me parime dhe principe të larta europiane. Në këtë kontekst, ne do të punojmë për të eliminuar hendekun gjinor në paga, shpërblime dhe pensione. Realizimi i këtij objektivi e vendos KSSH-në përballë një sfide, realizimi i të cilës sjelltribute të merituar për shoqërinë shqiptare.

Ne, respektojmë dhe kemi ndjeshmëri ndaj nevojave të veçanta të të dy gjinive, ne njohim, vlerësojmë dhe respektojmë diversitetin, ne jemi të angazhuar për tolerancë zero kundër dhunës ndaj grave dhe vajzave, dhunës në familje, si dhe kundër çfarëdo lloj forme të dhunës. Me inisiativën e KSSH-së, tanimë Qeveria Shqiptare filloi punën për ratifikimin e Konventës Nr. 190 të Organizatës Ndërkombëtare të Punës (ILO) “Për Dhunën dhe Ngacmimin” shoqëruar nga Rekomandimi Nr. 206 të ILO-s “Për Dhunën dhe Ngacmimin”, të cilat kanë për qëllim parësor garantimin e një mjedisi pune pa dhunë me bazë gjinore dhe pa ngacmime në vendin e punës.

KSSH, duke njohur dhe respektuar të drejtën e gjithësecilit për një botë pune pa dhunë dhe pa ngacmime seksuale do të referojë dhe adresojë të gjitha sjelljet dhe praktikatat e papranueshme, si dhe të gjitha kërcënimet të bëra grave dhe vajzave, qofshin këto një dukuri e vetme apo një fenomen i përsëritur, i cili mund të rezultojë në dhunë fizike, dëm psikologjik, seksual ose ekonomik.

Miratimi i kësaj Konvente ka një fushë të gjërë zbatimi, pasi pas miratimit të saj mbrohen jo vetëm të gjithë punonjësit, por edhe të gjithë personat e tjerë të cilët janë të përfshirë në botën e punës dhe që sipas praktikave kombëtare dhe ndërkombëtare, pavarsisht nga statusi i tyre kontraktues në punë, si punëmarrës, persona në trajnim, praktikantë, vullnetarë, punëkërkes ose individë që ushtrojnë autoritetin, detyrat apo përgjegjësitë e një punëdhënësi, ata janë subjekte që përfitojnë mbrojtje nga dispozitat e kësaj Konvente me rëndësi jetike për shoqërinë shqiptare.

Miratuar në Kongresin e 6-të të KSSH-së.